

Përdorimi i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Ndërmarrje (TIK)

Metadate Referenciale në format Euro SDMX Metadata Structure
(ESMS)

INSTAT

Metadate Referenciale

1. Kontakt.....	2
2. Përditësimi i metadatave	2
3. Paraqitja statistikore.....	2
4. Njësia matëse	6
5. Periudha e referencës	7
6. Mandati institucional	7
7. Konfidencialiteti	7
8. Politika e botimit.....	8
9. Shpeshtësia e shpërndarjes.....	9
10. Aksesimi në të dhëna dhe qartësia	9
11. Manaxhimi i cilësisë	10
12. Rëndësia.....	10
13. Saktësia dhe besueshmëria.....	11
14. Afatet kohore dhe përpikmëria	12
15. Koherenca dhe Krahasueshmëria.....	13
16. Kostoja dhe ngarkesa	13
17. Rishikimi i të dhënave	13
18. Përpunimi statistikor	14
19. Komente.....	16
Aneks 1	16

1. Kontakt	
1.1. Institucioni i kontaktit	Instituti i Statistikave, INSTAT
1.2. Njësia e kontaktit	Spektori i Statistikave të Kërkim-Zhvillimit, Inovacionit, Teknologjisë së Informacionit dhe Transportit
1.3. Personi i kontaktit	Irsida Nuellari
1.4. Funksioni i personit të kontaktit	Përgjegjës Spektori
1.5. Adresa postare	Rr. Vllazën Huta, Nd.35, H.1 Njësia Administrative Nr.2, 1017 Tiranë.
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	inuellari@instat.gov.al
1.7. Numri i telefonit	+ 355 (4)2 2233357/249
1.8. Numri i faksit	+(355) 4 2228300
2. Përditësimi i metadatave	
2.1. Çertifikimi i fundit i metadatës	25.02.2021
2.2. Publikimi i fundit i metadatës	28.05.2020
2.3. Përditësimi i fundit i metadatës	25.02.2021
3. Paraqitja statistikore	
3.1. Përshkrimi i të dhënave	<p>Qëllimi i statistikave të përdorimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në ndërmarrje është të sigurojë informacion të harmonizuar dhe të krahasueshëm për Përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) nga ana e ndërmarrjeve.</p> <p>Të dhënat e përdorimit të TIK në ndërmarrje tregojnë se në çfarë mase ndërmarrjet me 10 e më shumë të punësuar përdorin Teknologji Informacioni dhe Komunikimi (TIK), shesin ose blejnë përmes faqeve të internetit ose përmes shkëmbimit të të dhënave kompjuterike, d.m.th. shkallës së digjitalizimit të ndërmarrjeve. Përcaktimi i prioriteteve bëhet në përputhje me Rregulloren Nr. 808/2004 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit (KE) në lidhje me statistikat e Komunitetit për Shoqërinë e Informacionit, Rregulloret zbatuese të BE për vitet individuale si dhe Programin Kombëtar të Statistikave Zyrtare 2017-2021.</p>

<p>3.2. Sistemi i klasifikimit</p>	<p>Klasifikimi i përdorur për statistikat e Teknologjisë së Informacionit në ndërmarrje është Klasifikimi Statistikor i Aktiviteteve Ekonomike NVE Rev.2.</p> <p>Në vrojtim u mbuluan ndërmarrjet e zgjedhura nga Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve të regjistruara në Republikën e Shqipërisë dhe që ushtrojnë aktivitetet në një nga aktivitetet e klasifikuara sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike, NVE Rev.2, në nivel dy shifror që i korrespondon nivel seksioni duke përfshirë nga seksionet C deri në N (duke përjashtuar K aktivitetet financiare dhe të sigurimit), d.m.th në (C) Industri përpunuese, (D) Energji elektrike, gaz, avull dhe furnizim me ajër të kondicionuar, (E) Furnizimi me ujë,aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve, (F) Ndërtim, (G) Tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i automjeteve dhe motoçikletave, (H) Transporti dhe Magazinimi, (I) Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit ushqimor, (J) Informacioni dhe komunikimi, (L) Pasuri të paluajtshme, M (Grupet 69-74) Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike (pa përfshirë aktivitetet veterinare), (N) Shërbime administrative dhe mbështetëse, S (Grupi 95.1) Riparimi i kompjuterëve dhe i pajisjeve të komunikimit.</p>
<p>3.3. Mbulimi i sektorit</p>	<p>Statistikat e përdorimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në ndërmarrje bazohen në kampion me zgjedhje. Popullsia bazohet në ndërmarrjet të cilat, sipas Regjistrat Statistikor të Ndërmarrjeve, ishin aktive në Dhjetor të vitit të referencës dhe ushtrojnë veprimtarinë e tyre në një prej aktiviteteve të mbuluara nga statistikat e TIK në ndërmarrje. Kampioni është stratifikuar duke përdorur si variabla stratifikimi madhësinë dhe aktivitetin e ndërmarrjes (sipas NVE Rev.2). Bazë e zgjedhjes shërben Regjistri i ndërmarrjeve (i vitit të mbyllur), nga i cili përjashtohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Filialet e ndërmarrjeve. • Ndërmarrjet me aktivitet (NACE_kod) jashtë fushe. • Ndërmarrjet me më pak se 10 të punësuar. <p>Aktivitetet e mbuluara në këtë vrojtim janë nga seksionet C deri në N (duke përjashtuar aktivitetet financiare dhe të sigurimit - K) të NVE Rev.2, (C) Industri përpunuese, (D) Energji elektrike, gaz, avull dhe furnizim me ajër të kondicionuar, (E) Furnizimi me ujë,aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve, (F) Ndërtim, (G) Tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i automjeteve dhe motoçikletave, (H) Transporti dhe Magazinimi, (I) Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit ushqimor, (J) Informacioni dhe komunikimi, (L) Pasuri të paluajtshme, M (Grupet 69-74) Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike (pa përfshirë aktivitetet veterinare), (N) Shërbime administrative dhe mbështetëse, S (Grupi 95.1) Riparimi i kompjuterëve dhe i pajisjeve të komunikimit (95.1).</p>
<p>3.4. Koncepte statistikore dhe përkufizime</p>	<p>Treguesit bazë</p> <p>Treguesit kryesorë në këtë vrojtim janë tregues lidhur me zhvillimin dhe monitorimin e sipërmarrjes digjitale. Midis këtyre treguesve janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përqindja e ndërmarrjeve që kanë akses në kompjuter • Përqindja e ndërmarrjeve që kanë akses në internet

- Përqindja e ndërmarrjeve që kanë punësuar punonjës TIK
- Përqindja e ndërmarrjeve që kanë akses në internet të tipit broadband
- Përqindja e ndërmarrjeve që kanë akses në faqe internet (website)
- Përqindja e ndërmarrjeve që kanë një lloj të medias sociale
- Ndërmarrjet që kanë kryer shitje/blerje online

Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit janë hardware dhe software (kompjuter, telefona celularë, Internet, sistemi operacional, software kompjuterik, aplikacione celular, etj.) që mundësojnë mbledhjen, ruajtjen, përdorimin dhe transmetimin e të dhënave.

Aftësitë TIK janë aftësi që mundësojnë përdorimin efektiv të mjeteve të zakonshme ose të përparuara të programeve kompjuterike (kompjuterë, programe kompjuterike, internet).

Specialistët e TIK ose IT janë punonjës për të cilët puna kryesore është zhvillimi i TIK-ut, operimi ose mirëmbajtja e sistemeve ose aplikacioneve të TIK-ut.

Kompjuter: Kompjuterat përfshijnë kompjuterat personalë, tabletët apo pajisje të tjera portabël si Smartphone apo Personal Digital Assistants (PDAs).

Akses në Internet: Termi “Akses në Internet” i referohet një lidhjeje të jashtme në Internet përmes një kompanie që operon si Ofrues i Shërbimit në Internet (Internet Service Provider – ISP).

Broadband: Janë teknologjitë apo lidhjet të cilat mundësojnë transmetimin e shpejtë të të dhënave, si psh: filma, lojra, video-konferenca nëpërmjet një rrjeti interneti (për shembull: ADSL, lidhje kabllor, UMTS, lidhje optike, VDSL, linja me qira).

Website: Faqja e internetit është një dokument me HyperText. Ekzistenca e një website i ofron ndërmarrjes potencial për një performancë më të mirë, mundësi të reja për prezantimin e ndërmarrjes, produkteve, mundësi për njohje më të madhe dhe në të njëjtën kohë akses në tregje të reja dhe për rrjedhojë të ardhura më të larta. Faqet e internetit mund të kenë tekst, lidhje HyperText, imazhe, video dhe zëra.

Media Sociale: Është një tërësi teknologjish në internet 2.0 që mundësojnë shkëmbimin e informacionit interaktiv, ndërveprimin dhe krijimin e orientuar nga përdoruesit. Mediat sociale përfshijnë: rrjetet sociale, blogjet ose mikroblogjet, faqet e internetit për ndarjen e përmbajtjeve multimediale dhe mjetet për shkëmbimin e njohurive bazuar në Wiki. Ndërmarrjet i përdorin ato, p.sh. Facebook, Google+, Twitter, YouTube, etj., për lidhjen, krijimin ose shkëmbimin e përmbajtjes, informacionit në internet, me klientët, furnitorët, partnerët ose brenda një ndërmarrje midis punonjësve. Ndërmarrja përdor media sociale nëse ka një profil, llogari ose licencë të përdoruesit, sipas kërkesave dhe llojit të mediave sociale.

EDI, tip EDI i mesazheve: Shkëmbimi elektronik i të dhënave (EDI) i referohet transmetimit të strukturuar të të dhënave ose dokumenteve ndërmjet organizatave

ose ndërmarrjeve me anë të mjeteve elektronike. Ai gjithashtu i referohet posaçërisht një familje standardesh (të tipit EDI) dhe mesazheve të tipit EDI të përshtatshme për përpunim të automatizuar.

Tregtia elektronike: Një transaksion i tregtisë elektronike është shitja ose blerja e të mirave apo shërbimeve përmes rrjeteve kompjuterike me metoda të dizenuara në mënyrë specifike për qëllimin e marrjes ose kryerjes së porosive. Të mirat ose shërbimet porositen përmes këtyre metodave, ndërsa dorëzimi final dhe pagesa mund të mos kryhen online. Transaksionet e tregtisë elektronike përjashtojnë porositë e bëra përmes mesazheve të email-eve të shtypura manualisht.

Tregtia elektronike EDI: Porositë e iniciuara me mesazhe të tipit EDI. Shkëmbimi elektronik i të dhënave, EDI, është një mjet e-biznesi për shkëmbimin e llojeve të ndryshme të mesazheve të biznesit. EDI përdoret si një term i përgjithshëm për dërgimin ose marrjen e informacionit të biznesit në një format të përshtatshëm për përpunim të automatizuar (p.sh. EDIFACT, XML, etj.) dhe pa shtypur manualisht mesazh individual.

Shërbimet cloud: I referohen shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, që përdoren në internet për të aksesuar programe kompjuterike, kapacitete ruajtëse, etj.

Ndarja automatike e informacionit brenda ndërmarrjes: Një paketë programesh kompjuterike, e cila përdoret për planifikimin dhe menaxhimin e burimeve të ndërmarrjes, duke ndarë informacionet midis fushave të ndryshme funksionale (p.sh. kontabilitet, planifikim, prodhim, marketing, etj).

Software-it CRM: I referohet çdo aplikacioni software për menaxhimin e informacionit rreth klientëve.

Ndarja e informacionit elektronik për zinxhirët e furnizimit: Dërgimi/marrja e të gjithë informacionit mbi vargun e furnizimit (p.sh. nivelet e inventarit, planet e prodhimit, parashikimet, ecuria e dërgimit) nëpërmjet rrjeteve kompjuterike ose faqeve të internetit, por duke përjashtuar mesazhet email të shkruara manualisht.

Printimi 3D: Përdorimi i printerave të veçantë nga vetë ndërmarrja ose përdorimi i shërbimeve të printimit 3D të ofruara nga ndërmarrjet e tjera për krijimin e objekteve fizike tre-dimensionale duke përdorur teknologjinë digjitale.

Robotikë: Sipas aplikimit të tyre, robotët mund të jenë robotë industrialë ose të shërbimit. Një robot industrial është një manipulues i kontrolluar automatikisht, i riprogramueshëm, me shumë qëllime, i programueshëm në tre ose më shumë akse, i cili mund të jetë i fiksuar në vend ose i lëvizshëm për t'u përdorur në aplikacionet e automatizimit industrial. Një robot shërbimi është një makinë që ka një shkallë të autonomisë dhe është në gjendje të veprojë në një mjedis kompleks dhe dinamik që mund të kërkojë bashkëveprim me persona, objekte

	ose pajisje të tjera, duke përjashtuar përdorimin e tij në aplikacionet e automatizimit industrial.
3.5. Njësia statistikore	Njësia statistikore e synuar dhe e vrojtuar është ndërmarrja me mbi 10 të punësuar. Të dhënat e publikuara sipas aktiviteteve ekonomike dhe madhësisë së ndërmarrjes i referohen ndërmarrjes.
3.6. Popullata statistikore	<p>Statistikat përfshijnë të gjitha ndërmarrjet aktive në Shqipëri, të të gjitha formave ligjore. Bazë e zgjedhjes shërben Regjistri Statistikor i ndërmarrjeve (i vitit të mbyllur), nga i cili përjashtohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Filialet e ndërmarrjeve • Ndërmarrjet me aktivitet (NACE_kod) jashtë fushe • Ndërmarrjet me me pak se 10 të punësuar
3.7. Zona e referencës	Të dhënat e TIK në ndërmarrje mbulojnë të gjithë territorin e vendit.
3.8. Mbulimi në kohë	Ky aktivitet statistikor ka filluar në vitin 2015. Të dhënat janë të plota dhe të krahasueshme për serinë kohore 2015-2020.
3.9. Periudha bazë	Nuk aplikohet vit bazë.
4. Njësia matëse	<p>Është përdorur përqindja si njësi matëse për listën e mëposhtme të treguesve:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përqindja e ndërmarrjeve që kanë përdorur kompjuter për qëllime pune • Përqindja e ndërmarrjeve që kanë specialist të fushës së teknologjisë së informacionit • Përqindja e ndërmarrjeve që kanë punonjësit që përdorin kompjuter për qëllime pune • Përqindja e ndërmarrjeve që përdorin kompjuter me akses në internet, si dhe përqindjen sipas madhësisë së ndërmarrjes • Përqindja e ndërmarrjeve që përdorin lidhje fikse në internet • Përqindja e ndërmarrjeve që kanë faqe interneti/website • Përqindja e ndërmarrjeve që kanë shitur produkte/shërbime nëpërmjet faqes së internetit apo aplikacioneve të dedikuara, si dhe % sipas aktivitetit të ndërmarrjes • Përqindja e ndërmarrjeve që kanë përdorur shërbimet cloud • Përqindja e ndërmarrjeve që kanë përdorur ndarja automatike e informacionit brenda tyre • Përqindja e ndërmarrjeve që kanë aplikuar software-in për menaxhimin e marrëdhënieve me klientët (CRM) • Përqindja e ndërmarrjeve që kanë përdorur informacionin elektronik për zinxhirët e informacionit i cili i referohet dërgimit/marrjes së të gjithë informacionit mbi vargun e furnizimit nëpërmjet rrjeteve kompjuterike ose faqeve të internetit • Përqindja e ndërmarrjeve që kanë përdorur median sociale

	<ul style="list-style-type: none"> •Përqindja e ndërmarrjeve që kanë përdorur median sociale për të përmirësuar imazhin e ndërmarrjes ose të tregut të produkteve •Përqindja e ndërmarrjeve që kanë përdorur median sociale për të shkëmbyer mendime, opinione apo njohuri brenda ndërmarrjes •Përqindja e ndërmarrjeve që kanë përdorur robotë industriale ose robotë shërbimi.
5. Periudha e referencës	Të dhënat i përkasin periudhës vjetore kalendarike. Ky raport i përket vitit referencë 2020.
6. Mandati institucional	
6.1. Akte ligjore dhe marrëveshje të tjera	<p>Baza ligjore mbi të cilën u mbështetet vrojtimi vjetor i statistikave të Përdorimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit përbëhet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ligji Nr. 17/2018, "Për Statistikat Zyrtare" • Programi i Statistikave Zyrtare për periudhën 2017- 2021 • Vendimet e Këshillit të Statistikave. <p>Duke qenë se, sipas Nenit 6, të Ligjit "Për Statistika zyrtare", roli i këtij organi është të mbikëqyrë, mbështesë dhe të marrë vendime në ndihmë të INSTAT-it dhe agjencive të tjera statistikore për të siguruar hartimin dhe zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare, aktet e miratuara nga ky organ janë të rëndësishme për ecurinë e zbatimit të aktiviteteve statistikore si dhe monitorimin e performancës së institucioneve përbërëse të Sistemit Kombëtar Statistikor. Edhe pse Shqipëria nuk është ende pjesë e Bashkimit Europian, INSTAT kryen të gjitha aktivitetet statistikore në përputhje me rregulloret respektive të EUROSTAT. Rezultatet e vrojtimin TIK në ndërmarrje, në mënyrë që të jenë të krahasueshme me ato të vendeve evropiane, prodhohen duke zbatuar edhe rregulloret e reja të Komisionit Evropian, KE:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rregulloren Nr. 808/2004 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit (KE) në lidhje me statistikat e Komunitetit për Shoqërinë e Informacioni. • Rregulloret zbatuese të BE për vitet individuale.
6.2. Shkëmbimi i të dhënave	Statistikat e përdorimit TIK në ndërmarrje nuk transmetohen në EUROSTAT. Aktualisht, INSTAT plotëson një sërë pyetësorësh të organizmave ndërkombëtare në lidhje me rezultatet e vrojtimin TIK në ndërmarrje, si: pyetësorë të Komisionit Evropian, Eurostat (Pyetësori i vendeve në zgjerim), pyetësori i SEE 2020, pyetësori i OECD, Indeksi DESI, etj. INSTAT parashikon të transmetojë të dhënat e TIK në ndërmarrje sa më shpejt në EUROSTAT.
7. Konfidencialiteti	
7.1. Konfidencialiteti - politika	Të dhënat e mbledhura konsiderohen rreptësisht konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore e kërkime shkencore në përputhje me Ligj Nr. 17/2018 "Për Statistikat zyrtare", si dhe Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Mbrojtja e të Dhënave Personale". Neni 31 i ligjit "Për Statistikat Zyrtare" përcakton qartë që i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT është

	<p>konfidencial dhe mund të përdoret ose botohet vetëm në tabela përmbledhëse të tilla që nuk identifikojnë njësinë burim të informacionit. Identifikim i drejtpërdrejtë quhet kur një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njohur zyrtarisht. Kur përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshëm.</p>
<p>7.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave</p>	<p>INSTAT mbron dhe nuk shpërndan të dhënat që ka mbledhur ose që ka akses, të cilat mundësojnë identifikimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të njësive statistikore. INSTAT ndërmerret të gjitha masat e duhura për të parandaluar dhe bërë të pamundur identifikimin e njësive statistikore përmes mjeteve teknike të tjera që mund të përdoren nga palët e treta. Të dhënat statistikore që mund të bëjnë të mundur identifikimin e njësisë statistikore, shpërndahen nga INSTAT vetëm në rast se:</p> <p>a) Këto të dhëna janë trajtuar, siç është përcaktuar në mënyrë të veçantë në Rregullore, këto të dhëna janë trajtuar në mënyrë të atillë, sa nuk krijon paragjykim në lidhje me konfidencialitetin statistikor; ose</p> <p>b) Njësia statistikore ka dhënë miratimin përkatës për bërjen publike të të dhënave;</p> <p>Të dhënat konfidenciale i përcillen INSTAT-it vetëm për qëllime statistikore dhe vetëm personat që kanë të drejtë aksesit tek to, mund të punojnë me to. Çështjet dhe problemet në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit statistikor verifikohen dhe trajtohen nga stafi i INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi, janë të përcaktojnë shkallën e detajeve që mund të shpërndahet dhe të bëhet publike nga INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi janë të rekomandojnë se: në cilin nivel detajimi mund të shpërndahen të dhënat statistikore, në mënyrë që identifikimi i drejtpërdrejtë ose indirekt, i njësisë statistikore të vrotuar të mos jetë i mundur; kriteret e anonimizimit për mikrodatat që u janë dhënë përdoruesve; dhënia e hyrjes për hulumtuesit në të dhëna konfidenciale për qëllime shkencore.</p> <p>Nga të dhënat në nivel individual të TIK në ndërmarrje largohen të gjitha të dhënat demografike të ndërmarrjes, si Nipt-i, emri i ndërmarrjes, emri dhe mbiemri i presidentit, data e krijimit të ndërmarrjes dhe adresa e saj. Fillimisht shënjohej me (c) si konfidenciale rastet e grupimeve që kanë 3 ose më pak ndërmarrje si edhe rastet kur përqindja që zënë dy ndërmarrjet më të mëdha kalon 75%. Më pas shënjohej me (c) rastet të cilat do të çonin në identifikimin indirekt të ndërmarrjeve.</p>
<p>8. Politika e botimit</p>	
<p>8.1. Kalendar i publikimeve</p>	<p>Njoftimet në lidhje me shpërndarjen e statistikave janë botuar në kalendarin e publikimit, i cili është në dispozicion në faqen e internetit. Njoftime dhe vonesat janë para-njoftuar në këtë kalendar. Në rastin e vonesave specifikohet data e publikimit të ardhshëm si dhe shpjegimi lidhur me arsyet e vonesave.</p>

8.2. Akses i kalendarin e publikimeve	Kalendari i Publikimeve është në dispozicion në faqen e internetit të INSTAT.
8.3. Akses i përdoruesve	<p>Në përputhje me nenin 34 të Ligjit Nr. 17/2018 "Për Statistikat Zyrtare", statistikatat zyrtare shpërndahen në mënyrë që të gjithë përdoruesit të kenë të drejtë të menjëhershme dhe të barabartë dhe përdoren të gjitha format e mundshme të medias. INSTAT-i dhe agjencitë statistikore, duke pasur në program përgjegjësitë për shpërndarjen, kërkojnë të përmbushin çdo kërkesë të çdo organizate ose individit, për të dhëna të pabotuara ose analiza të veçanta. Kanalet nga të cilat përdoruesit mund të marrin rezultatet e publikimit vjetor të Anketës së Përdorimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit pranë ndërmarrjeve janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Njoftimi për shtyp 2. Të dhënat në formë tabelare 3. Kërkesa për të dhëna nëpërmjet formularit në website e INSTAT
9. Shpeshësia e shpërndarjes	Rezultatet e Anketës së "Përdorimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në ndërmarrje" publikohen në baza vjetore.
10. Akses i të dhëna dhe qartësia	
10.1. Njoftim për media	<p>Njoftimi për shtyp përmban informacion në lidhje me treguesit kryesorë të siguruar nga vrojtimi si: ndërmarrjet që kanë kompjuter, ndërmarrjet që kanë internet, ndërmarrjet që kanë internet të tipit broadband, ndërmarrjet që kanë faqe internet (website), ndërmarrjet që kanë kryer shitje/blerje online, etj. Format i njoftimit për shtyp nuk ka ndryshuar, ky format përcaktohet nga sektori i publikimit.</p> <p>Njoftimi për shtyp i TIK në ndërmarrje publikohet online në faqen e internetit të INSTAT.</p>
10.2. Publikime	Rezultatet e përdorimit të TIK në ndërmarrje gjenden të botuara në botimin "Shqipëria në Shifra". Përdoruesit mund t'i gjejnë rezultatet në faqen e internetit të INSTAT: Shqipëria në Shifra .
10.3. Baza e të dhënave on-line	Të gjitha informacionet vihen në dispozicion në dy gjuhë: Shqip dhe Anglisht. Të dhënat e përdorimit të TIK në ndërmarrje nuk janë të vendosura në databazën statistikore, por të dhëna të detajuara mund të gjenden në format Excel ku treguesit kryesorë jepen të detajuar sipas aktivitetit ekonomik dhe madhësisë së ndërmarrjes. Këto tabela mund të gjenden në linkun Informacioni dhe Teknologjitë e Komunikimit në ndërmarrje .
10.4. Akses i të dhënat mikro	Të dhënat e përdorimit të TIK në ndërmarrje nuk bëhen të disponueshme në nivel mikro, si pasojë e ruajtjes së konfidencialitetit. Të dhënat e agreguara, janë lloji i vetëm i të dhënave që ofrohet për përdoruesit e jashtëm. Edhe pse të dhënat mikro nuk publikohen, ato mund të aksesohen në bazë të nenit 34 të Ligjit Nr. 17/2018 "Për Statistikat Zyrtare".

10.5. Të tjera	Përdoruesit mund të dërgojnë kërkesa të tjera specifike nëpërmjet një sesioni të dedikuar për kontaktet sipas linkut Kërkesë të dhënash formulari .
10.6. Dokumentimi i metodologjisë	Një shpjegim i shkurtër lidhur me përkufizimet, konceptet kryesore dhe shpjegimet metodologjike për përdoruesit publikohet në njoftimin për shtyp dhe publikimet. Informacione shtesë u jepen përdoruesve të brendshëm kur është e nevojshme. Në faqen e INSTAT ka një seksion lidhur me Metodogjinë mbi vrojtimin.
10.7. Dokumentimi i cilësisë	Sektori i Statistikave të Kërkim-Zhvillimit, Inovacionit, Teknologjisë së Informacionit dhe Transportit dokumenton të gjithë procesin e punës dhe procedurat e TIK në ndërmarrje për qëllime të brendshme.
11. Manaxhimi i cilësisë	
11.1. Sigurimi i cilësisë	INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në ligjin Nr.17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”, INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranura ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice). INSTAT për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore, orientimi për përdoruesit, orientimi për punonjësit, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës së të intervistuarve.
11.2. Vlerësimi i cilësisë	Të dhënat e përdorimit të TIK në ndërmarrje krahasohen me të dhënat në vitet e mëparshme për të dalluar nëse ka koherencë të dhënash apo ka pasur ndryshime të mëdha. Në rastet e ndryshimeve përdoren të dhënat nga burime të tjera të mundshme për të konfirmuar situatën e rasteve kur hasen diferenca të mëdha të sjelljes së një viti me vitet e tjera.
12. Rëndësia	
12.1. Nevojat e përdoruesit	Përdoruesit e përdorimit të TIK në ndërmarrje ndahen në përdorues të brendshëm dhe të jashtëm. <ul style="list-style-type: none"> • Përdorues të jashtëm: <ul style="list-style-type: none"> o Institucione të administratës publike o Universitetet o Organizatat jo fitimprurëse kombëtare dhe ndërkombëtare o Bizneset o Kërkues, student edhe të tjerë grupe të ngjashme. • Përdorues të brendshëm janë sektorë të tjerë brenda INSTAT të cilët përdorin rezultatet e përdorimit të TIK në ndërmarrje si input në punën e tyre.

	<p>Botimi i rezultateve të TIK në ndërmarrje dërgohet çdo vit në një grup të caktuar përdoruesish. Disa tregues kryesorë dërgohen nga plotësimi i pyetësorëve të ndryshëm në Komisionin Evropian, Eurostat (Pyetësi i vendeve në zgjerim), pyetësi i SEE 2020, Indeksi i Ekonomisë dhe Shoqërisë Dixhitale, etj.</p>
12.2. Kënaqësia e përdoruesit	<p>Klikimet (Page Views) në lidhje me TIK në ndërmarrje për vitin 2020 janë rreth 1,236 klikime. INSTAT ka kryer vrojtimin për matjen e kënaqësisë së përdoruesve nga publikimet e INSTAT. Rezultatet e vërtetimit tregojnë se cilësia e përgjithshme e temës "Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit në Ndërmarrje" është vlerësuar me 3.71 (74.2%) nga një shkallë prej 1 (shumë dobët) deri në 5 (shumë mirë).</p> <p>INSTAT organizon çdo vit Anketën e Kënaqësisë së Përdoruesve.</p>
12.3. Plotshmëria	<p>Plotëshmëria e të dhënave të TIK në ndërmarrje gjykohet duke krahasuar cilësinë dhe sasinë e treguesve të mbuluar në INSTAT nga ato të rregullore të ndjekura. Statistikat e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në ndërmarrje në mënyrë që të jenë të krahasueshme me ato të vendeve evropiane, prodhohen duke zbatuar edhe rregulloret e reja të Komisionit Evropian, KE:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rregullorja e KE Nr. 2018/1798 e datës 21 Nëntor 2018, e cila është Rregullore zbatuese e Rregullores së KE me Nr. 808/2004 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit në lidhje me statistikën e Komunitetit mbi Shoqërinë e informacionit për vitin referues 2019 • Rregullorja e KE Nr. 2017/1515 e datës 31 Gusht, e cila është Rregullore zbatuese e Rregullores së KE me Nr. 808/2004 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit në lidhje me statistikën e Komunitetit mbi Shoqërinë e Informacionit për vitin referues 2018 • Rregullorja e KE 2016/2015 e datës 17 nëntor 2016, e cila është Rregullore zbatuese e Rregullores së KE me Nr. 808/2004 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit në lidhje me statistikën e Komunitetit për Shoqërinë e Informacionit <p>Shkalla e Plotshmërisë të të dhënave, për Anketën e përdorimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në ndërmarrje është 100% për vitin 2020 duke qënë se pyetësi dhe metodologjia e përdorur në këtë vërtim janë në përputhje të plotë me kërkesat që kërkohen nga EUROSTAT.</p>
13. Saktësia dhe besueshmëria	
13.1. Saktësia e përgjithshme	<p>Në përgjithësi, të dhënat janë kontrolluar me vitet e mëparshme për të identifikuar ndryshime të rëndësishme në ecurinë e të dhënave. Në rastet kur hasen ndryshime të dhënave të anketës kontrollohen me burime alternative, nëse ka informacion. Kur nuk ka informacion nga burimet alternative, INSTAT korrigjon ose konfirmon të dhënat duke përdorur email ose duke telefonuar personat që i janë përgjigjur anketës. Masat e marra nga INSTAT çdo vit, për të rritur normat e përgjigjes, ose për të zvogëluar ndikimin e mos përgjigjeve janë si më poshtë:</p>

	<ul style="list-style-type: none"> • Të dhënat merren drejtpërdrejt nga ndërmarrja • Grumbullimi i të dhënave realizohet me metodën CAPI, nëpërmjet intervistës ballë për ballë me anketues me tabletë. • Stafi anketues është i trajnuar se si të sillen në mënyrë etike me rastet e personave të cilët refuzojnë të përgjigjen. • Për shkak të mungesës së sistemit të adresave, shpesh nga anketuesit është e vështirë gjetja e ndërmarrjes. Për këtë arsye, stafi i INSTAT nëpërmjet adresës së email-it ose numrit të telefonit kontakton personin përgjegjës për plotësimin e anketës dhe merr më tepër informacion mbi vendndodhjen si edhe datën dhe orën e takimit. • Prioritet i jepet bizneseve të mëdha. Kur këto ndërmarrje refuzon të përgjigjet për intervistuesit, një kërkesë zyrtare i drejtohet presidentit të ndërmarrjes, e cila është e nënshkruar nga drejtori i përgjithshëm i INSTAT. • Kërkesë zyrtare dërgohet edhe për ndërmarrje të tjera që pranojnë të përgjigjen vetëm nëse ju kërkohet zyrtarisht informacioni. • Ndërmarrjet janë të ftuar të kontaktojnë zyrat qendrore të Institutit të Statistikave në rast të pyetjeve dhe gjithmonë një staf i kualifikuar është në dispozicion për t'iu përgjigjur pyetjeve të drejtuara nga ndërmarrjet. • Përdorimi i tabletit për mbledhjen e të dhënave është një mënyrë për minimizimin e kohës së intervistimit dhe kalimit të pyetjeve. 				
13.2. Gabim i kampionimit	Treguesit e gabimeve të kampionimit janë llogaritur për indikatorët kryesorë, të cilët i gjeni në Tabelën A1 të Aneks 1. Të gjitha vlerat e treguesve përgjithësohen për të përfaqësuar gjithë popullatën në studim.				
13.3. Gabim jo i kampionimit	<p>Mos-përgjigja në nivel rekordi merr në konsideratë ndërmarrjet që nuk janë në gjendje apo të gatshme për të dhënë përgjigje ose kur intervistuesit nuk janë në gjendje për të gjetur ndërmarrjet, ose kur ekzistojnë pengesa të tjera për të përfunduar intervistën. Shkalla e mos- përgjigjes në nivel rekordi për TIK 2020 është 10.92%.</p> <p>Shkalla e mos-përgjigjes në nivel variabli për variablin “Përdorimi i kompjuterit” është 0.0% dhe për variablin “Përdorimi i internetit” është 0.0%.</p> <p>Mbi-mbulimi ndodh kur ndërmarrja e zgjedhur është në një aktivitet të caktuar objekt i anketimit dhe gjatë procesit të intervistimit ajo nuk është më objekt i anketimit ose statusi i ndërmarrjes ka ndryshuar, nuk është më aktive. Shkalla e mbi-mbulimit për TIK 2020 është 1.77%.</p>				
14. Afatet kohore dhe përpikmëria					
14.1. Afatet kohore	<p>Rezultatet e “Përdorimit të TIK në ndërmarrje” janë publikuar në faqen e internetit të INSTAT 56 ditë pas përfundimit të periudhës referuese (T + 56 ditë). Periudha referuese e rezultateve të TIK 2020 është 31 Dhjetori 2020.</p> <table border="1" data-bbox="472 1808 938 1875"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>12/31/2020</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>2/25/2021</td> </tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2020	Data e publikimit	2/25/2021
Periudha referuese	12/31/2020				
Data e publikimit	2/25/2021				

	Afatet kohore	56								
14.2. Përpikmëria	<p>Të dhënat e Anketës së TIK në ndërmarrje, publikohen bazuar në kalendarin e publikimeve. Publikimi i TIK në ndërmarrje ka qenë i përpiktë në kohë në 100 % të publikimeve të kryera gjatë viteve.</p> <table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>12/31/2020</td> </tr> <tr> <td>Data e shpallur</td> <td>2/25/2021</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>2/25/2021</td> </tr> <tr> <td>Vonesa në kohë</td> <td>0</td> </tr> </table>		Periudha referuese	12/31/2020	Data e shpallur	2/25/2021	Data e publikimit	2/25/2021	Vonesa në kohë	0
Periudha referuese	12/31/2020									
Data e shpallur	2/25/2021									
Data e publikimit	2/25/2021									
Vonesa në kohë	0									
15. Koherenca dhe Krahasueshmëria										
15.1. Krahasueshmëria gjeografike	<p>Të dhënat mbi Përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe komunikimit (TIK) në ndërmarrje janë mbledhur në bazë të Rregullores (KE) Nr. 808/2004 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit në lidhje me statistikat e Komunitetit për hoqërinë e informacionit, si dhe rregulloret vjetore të zbatimit, ku përcaktohen variablat e monitoruara për secilin vit. Të dhënat e përdorimit të TIK në ndërmarrje nuk transmetohen në Eurostat. Duke qenë se pyetësi i përdorur është i njëjtë me atë të EUROSTAT dhe ndiqen Rregulloret e Eurostat, statistikat e Përdorimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në ndërmarrje mund të jenë të krahasueshme me ato të vendeve anëtare.</p>									
15.2. Krahasueshmëria kohore	<p>Vrojtimi mbi Përdorimin e Teknologjive të Informacionit dhe komunikimit (TIK) në ndërmarrje monitoron zhvillimin e sipërmarrjes digjitale. Çdo vit, nga Eurostat dhe vendet anëtare vihet theksi në një temë specifike për fushën e shoqërisë digjitale. Prandaj, statistikat e caktuara monitorohen vetëm në një vit ose çdo vit tjetër, që do të thotë se statistikat individuale kanë gjatësi të ndryshme të krahasueshmërisë së serive kohore.</p> <p>Të dhënat e TIK në ndërmarrje janë prodhuar për herë të parë në vitin 2015. Të dhënat bazë janë të krahasueshme në seri kohore nga viti i fillimit të vërtetimit 2015-2020, duke na garantuar një krahasueshmeri prej 6 vitesh (CC2=Jlast-Jfirst+1=6).</p>									
15.3. Koherenca e ndërthurjes së fushave	<p>Nuk ka asnjë vërtetim tjetër apo burim administrativ i krahasueshëm i cili mund të merret si referencë për statistikat e Përdorimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në ndërmarrje. Disa nga treguesit kontrollohen me informacion i cili gjendet në Vetëm të dhënat përfundimtare të TIK në ndërmarrje publikohen.</p>									
15.4. Koherenca e brendshme	<p>Konsistenca e brendshme e të dhënave është kontrolluar para se të finalizohet. Kontrollohen gjithashtu lidhjet midis variablave dhe koherenca në seri e tyre.</p>									
16. Kostoja dhe ngarkesa	<p>Personat që punojnë për TIK në ndërmarrje janë: Staf i përgjithshëm në Zyrat Qendrore: 1 punonjës, Staf në Zyrat Rajonale, 11 punonjës, Intervistuesit, 54 gjithsej, 2 kontrollorë dhe 1 staf IT.</p>									
17. Rishikimi i të dhënave										

17.1. Politika e rishikimit	<p>Politikat e rishikimit të përdorimit TIK në ndërmarrje bëhen në përputhje me politikën e rishikimit si dhe politikën e trajtimit të gabimeve të vendosura nga INSTAT. Për më shumë referohuni:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Politika e Revizionimit Statistikor • Politika e Trajtimit të Gabimeve
17.2. Praktika e rishikimit	<p>Të dhënat e TIK rishikohen në rastet kur:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Zbatohet një klasifikim i ri aktivitetesh • Ka ndryshime metodologjike • Rishikohen peshat. <p>Për të dhënat e TIK përpiqet të ndiqen udhëzimet standarde dhe parimet në rishikimet e bëra në bashkëpunim me asistencën teknike të marrë nga eksperiencat më të mira të vendeve të Bashkimit Evropian.</p>
18. Përpunimi statistikor	
18.1. Burimi i të dhënave	<p>Si burim i vetëm i mbledhjes së të dhënave është vrojtimi. Popullata në studim për TIK 2020 përmban 6.673 ndërmarrje. Madhësia e kampionit të përzgjedhur është 1,752 ndërmarrje të të gjitha formave ligjore dhe llojeve të pronësisë, me 10 e më shumë të punësuar, nga të cilat rezultuan të përgjigjur 1,533 ndërmarrje.</p>
18.2. Shpeshësia e grumbullimit të të dhënave	<p>Të dhënat grumbullohen në baza vjetore.</p>
18.3. Grumbullimi i të dhënave	<p>Mbledhja e të dhënave kryhet me intervistim të drejtpërdrejtë me tabletë nga anketuesit, në ndërmarrjet e zgjedhura për anketim. Krahas të dhënave të grumbulluara nga anketa, sektori i statistikave të K&Zh, Inovacionit, TIK dhe Transportit analizon dhe përdor të dhënat nga vrojtimit e viteve të kaluara për TIK në ndërmarrje. Në ndryshim nga anketat ekonomike, personi që duhet të përgjigjet këtij vrojtimi është një vendimmarrës me përgjegjësi për çështjet që lidhen me TIK-në në ndërmarrje (menaxher i TIK-ut ose një profesionist i lartë në departamentin e TIK-ut). Në ndërmarrjet më të vogla, i anketuari duhet të jetë dikush në nivelin e drejtorit menaxhues ose të pronarit. Sidoqoftë, raportuesi i të dhënave nuk duhet të jetë dikush me përgjegjësi vetëm në kontabilitet.</p> <p>Faza e rëndësishme në përgatitjen për grumbullimin e të dhënave është përgatitja e të gjitha materialeve të nevojshme dhe e programeve të hedhjes dhe të përpunimit të të dhënave. Duhet që të jenë përcaktuar ndërmarrjet që do intervistohen, numri i nevojshëm i anketuesve dhe duhet të jetë bërë përzgjedhja e tyre. Gjatë trajnimit të organizuar për anketuesit se si të kryejnë vrojtimin ata gjithashtu pajisen materiale të nevojshme si udhëzuesi i pyetësorit, detyrat e anketuesit, lista e aktiviteteve ekonomik, letër njoftimit për ndërmarrjet, lap topi si dhe bëhet një trajnim si plotësohet një pyetësor me anë të lap topit duke patur parasysh çështjet teknike informatike, etj.</p> <p>Në procesin e mbledhjes së të dhënave janë të regjistruar çdo gjë e raportuar nga ndërmarrjet. Në rast të paqartësive, ndërmarrja ri-kontaktohet. Në rast të</p>

	<p>mospërgjegjes, ndërmarrjes i dërgohet një shkresë zyrtare e nënshkruar nga titullari i Institucionit. Anketuesit i kërkohet të silltet në mënyrë etike në rastet e refuzimeve nga ndërmarrjet.</p>
<p>18.4. Vlefshmëria e të dhënave</p>	<p>Sa i përket vlefshmërisë së të dhënave, procedurat e redaktimit të të dhënave në përgjithësi i referohen redaktimit në nivel mikro ose ndryshe në nivel ndërmarrje.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Kontrolli i të dhënave të hedhura në program. <ul style="list-style-type: none"> • Kontrolli i pyetësorëve të hedhur, kontrolle të tërësisë së plotësisimit, saktësisë së vlerave dhe kontrollit logjik i pyetësorit. Numri i pyetësorëve të hedhur në program duhet të jetë i barabartë me numrin e shpërndarjes së pyetësorëve në qarqe. • Kontrolle individuale janë bërë për rastet e refuzimit dhe pa kontakte. • Ndërmarrjet e përgjigjura kontrollohen për koherencën e të dhënave midis sesioneve të ndryshme të pyetësorit. 2. Kontrolli i disa pyetjeve me anë të informacionit që mund të gjendet nga kontaktimi individual i ndërmarrjeve. 3. Peshë e përshtatshme ri-llogaritit për çdo njësi që ka raportuar të dhënat e saj. Kjo peshë është ri-llogaritur për arsye të ndryshme: kemi probabilitet të pabarabartë të përzgjedhjes, mos-përgjigje, ndërmarrje që dalin jashtë qëllimit. Trajtimi i outlier-ave merret parasysh në procedurat e përgjithësisimit të rezultateve.
<p>18.5. Përpilimi i të dhënave</p>	<p>Për përpilimin e rezultateve kemi dy procedura bazë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Analiza e cilësisë së të dhënave Për të analizuar cilësinë e të dhënave janë aplikuar disa rregulla: <ul style="list-style-type: none"> • Kontrolli matematik i anketës - Kontrolli logjik i të dhënave të anketës • Krahasimi i të dhënave në seri kohore - Krahasimi i të dhënave me vitet e tjera • Krahasimi i të dhënave të punësimit dhe shitjeve neto me skedarin e Listpagesës dhe bilancet. • Analiza e shmangieve të mëdha nga mesatarja. 2. Trajtimi i mos-përgjigjeve Konsiderohen si mos-përgjigje të gjitha rastet: <ul style="list-style-type: none"> • Pa kontakt • Refuzim i plotë • Refuzime të pjesshme, (për tabela apo tregues të veçantë). <p>Për rastet e mospërgjigjeve duhet të bëhen korrigjime logjike, kur informacioni mund të nxirret nga variablat e tjerë dhe prioritet u jepet kontakteve të mëtejshme me ndërmarrjet për të mbledhur informacionet që mungojnë. Për variablat kategorike (p.sh. pyetjet Po / JO), të anketuarit me përgjigje jo të pyetjes ose 'nuk e di' nuk duhet të imputohen me vlerat e ndërmarrjeve që i janë përgjigjur pyetjes.</p>

18.6. Rregullimi	Nuk aplikohet.
19. Komete	

Aneks 1

Tabela A1. Treguesit e saktësisë së vlerësimeve për numër ndërmarrjesh gjithsej, ndërmarrje që përdorin kompjuter dhe ndërmarrje që kanë akses në internet

Gjithsej	Numër gjithsej i ndërmarrjeve	Devijimi standard	Intervali i besimit 95%		Koefficienti i Variacionit
			Limiti i Poshtëm	Limiti i Sipërm	
Numër ndërmarrjeve të vrojtuar	6,552	28.0	6,497	6,607	0.4%
Përdorimi i kompjuterit	6,443	41.0	6,363	6,524	0.6%
Përdorimi i internetit	6,313	56.7	6,202	6,424	0.9%

Përdorimi i kompjuterit, i shprehur në numër ndërmarrjesh për nivelin e besueshmërisë 95% gjendet mes vlerave 6,363 dhe 6,524, dhe ka një devijim standard prej 41.0, i shprehur në përqindje në formën e koefficientit të variacionit është 0.6%.

Përdorimi i internetit, i shprehur në numër ndërmarrjesh për nivelin e besueshmërisë 95% gjendet mes vlerave 6,202 dhe 6,424, dhe ka një devijim standard prej 56.7, i shprehur në përqindje në formën e koefficientit të variacionit është 0.9%.